

APOSTULLI - 1 Korinthianëve 7:12-24.



Edhe të tjerëve u them unë, jo Zoti, në ka ndonjë vëlla grua jobesimtare, edhe ajo dëshiron të rrojë bashkë me të, le të mos e lërë atë. Edhe një grua që ka burrë jobesimtar, dhe ai dëshiron të rrojë bashkë me të, le të mos e lërë atë.

Sepse burri jobesimtar është i shenjtëruar me anë të gruas; dhe gruaja jobesimtare është e shenjtëruar me anë të burrit; sepse ndryshe bijtë tuaj do të ishin të papastër; kurse tani janë shenjtorë. Por në u ndaftë jobesimtari, le të ndahet. Vëllai a motra nuk janë të robëruar në të tilla raste; po Perëndia na ka thirrur në paqe.

Sepse ç'di ti, o grua, në ke për të shpëtuar burrin? Ose ç'di ti, o burrë, në ke për të shpëtuar gruan?

Po secili siç ia caktoi Perëndia, secili siç e thirri Zoti, kështu le të ecin; edhe kështu urdhëroj mbi të gjitha kishat. U thërrit i rrethprerë ndonjë në besim? Le të mos e fshehë rrethprerjen. I parrethprerë u thërrit ndonjë? Le të mos rrethprietet. Rrethprerja s'është gjë, edhe parrethprerja s'është gjë, po ruajtja e porosive të Perëndisë.

Gjithësecili në atë thirrje që u thërrit, në atë le të mbesë. U thërrite kur ishe skllav? Mos u shqetëso për këtë. Por nëse mund të bëhesh i lirë, më mirë përdore këtë. Sepse ai që u thirr në Zotin kur qe skllav, është i çliruar i Zotit; gjithashtu edhe ai që u thirr kur qe i lirë, është skllav i Krishtit.

Me çmim u bletë; mos u bëni skllavë njerëzish. Gjithësecili, o vëllezër, në atë që u thirr, në këtë le të mbetet ndaj Perëndisë.

* * * * *

UNGJILLI – Mateu 14:35-15:11.

Edhe njerëzit e atij vendi, kur e njohën, dërguan nëpër gjithë ato anë dhe i prunë atij gjithë ata që kishin keq. Edhe i luteshin atij të preknin qoftë vetëm cepin e rrobës së tij. Edhe gjithë sa e prekën u shëruan.

Atëherë vijnë tek Jisui shkruarit dhe Farisenjtë nga Jerusalemi, e i thonë: Përse nxënësit e tu shkelin traditën e pleqve? Sepse s'lajnë duart e tyre, kur hanë bukë. Po ai u përgjigj e u tha atyre: Përse edhe ju shkelni urdhërimin e Perëndisë për hir të traditës suaj?

Sepse Perëndia urdhëroi, duke thënë: “Ndero atin dhe nënën”, dhe: “Ai që flet keq për të atin ose për të ëmën le të vritet”. Po ju thoni, “Kush t'i thotë të atit apo së ëmës se çdo ndihmë që do të merrje prej meje është dhuratë për Perëndinë”, dhe kështu ai mund të mos nderojë më të atin apo të ëmën.

Dhe hodhët poshtë urdhërimin e Perëndisë për hir të traditës suaj. Hipokritë! Mirë profetizoi Isaia për ju, duke thënë: “Ky popull më afrohet me gojën e tyre, edhe më nderon me buzët; por zemra e tyre është larg prej meje. Edhe kot më nderojnë, duke mësuar mësimë që janë urdhërime njerëzish”.

Edhe si thirri pranë turmën, u tha: Dëgjoni edhe kuptoni. Ajo që hyn në gojë nuk e ndyn njeriun, por ç'del nga goja, kjo e ndyn njeriun.

Rinia Ortodokse Tirane/facebook